

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se amendamentet që unë i kam paraqitur këtij parlamenti në fushën e arsimit janë tejet të rëndësishme për impaktin që do t'i japin jo vetëm edukimit, por edhe plagës së madhe të shpopullimit që po i ndodh vendit. Për sa u përket amendamenteve, amendamenti i parë është për pedagogët dhe kërkimin shkencor. Pedagogët prej javësh janë në protesta të vazhdueshme, e kërkesa shumë të drejta për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë. Këtu kam parasysh kërkesat minimaliste që ata kanë bërë. Në amendamentet e mia kërkesat e tyre të drejta i kam paraqitur dhe u kam dhënë zë në parlament.

Të mos harrojmë që kërkesat e tyre janë për një pagë dinjitoze sa kolegët e tyre në Kosovë, nuk kërkojnë asgjë më shumë se kolegët e tyre në Kosovë dhe, siç e kanë shprehur edhe ata vetë, kjo duhet të bëhet, sepse rrezikon që elita e vendit, intelektualët e vendit të largohen nga vendi në qoftë se nuk do të kenë një pagë dinjitoze për të mundësuar jo vetëm një jetesë në këtë vend, por të kenë mundësi edhe për zhvillimin e kërkimit shkencor, si një nga arsyet apo pse funksionojnë universitetet në Shqipëri. Për sa i përket kërkimit shkencor, i cili është i nënfinancuar, sot në projektbuxhetin që ju prezantoni është 0,05% të PPB-së.

Në raportin e fundit të Komisionit European, vetë BE-ja e ka thënë që minimalisht duhet të ishte 1% e PPB-së, ndërsa unë propozoj në këtë amendament, siç e kanë sugjeruar edhe pedagogët, që, të paktën, të shkojë në 0,3% të PPB-së. Në qoftë se flasim për ndërkombëtarizim të universiteteve dhe nuk u japim financim për kërkimin shkencor, atëherë çdo gjë mbetet në letër, ashtu sikundër edhe vetë rektorët ia bënë publike këto kërkesa Kryeministrit me ndërgjegjësimin që është një fushë, e cila duhet të financohët. Amendamenti tjetër ka të bëjë me mësuesit.

Në projektbuxhetin e vitit 2023 mësuesve duhet t'u rritet paga sipas propozimit të qeverisë 6% në muajin korrik të vitit 2023. Por çfarë do të bëjnë mësuesit gjatë kësaj periudhe, si do të mund t'i përballojnë sfidat që kanë dhe krizën e çmimeve të rritura? Për këtë arsye, personalisht, mendoj se mësuesit janë një kategori e shoqërisë, që duhet të marrin vlerësimin dhe duhet të jenë model

frymëzimi për shumë nga fëmijët. Është e pajustificueshme që mësuesit tanë punojnë gjatë verës për të siguruar pagën e tyre. Ky nuk mund të jetë një model pozitiv që mësuesit tanë, në vend që të përgatiten për veten e tyre, detyrohen të punojnë.

Propozimi im është që rritja e pagës së mësuesve të shkojë në 12%. Amendamenti tjetër ka të bëjë me librat. Librat falas të qeverisë, që ju propozoni, në fakt, janë libra të përdorur, jashtë funksionit dhe këtë e dimë të gjithë. Për këtë arsye propozoj që ta mbani premtimin dhe t'u jepni shansin e të mos diskriminoni fëmijët që nuk kanë mundësi të blejnë libra, por librat nga klasa I deri në klasën IX të jenë falas dhe të rinj për të gjithë vogëlushët e Shqipërisë. Duke qenë se Kryeministri ka thënë që lekë ka, por unë dua t'i edukoj dhe t'i sanksionoj prindërit nëse përdoret dhe nuk mbahet mirë libri, atëherë, duke qenë se lekët janë, le t'u japim shansin të gjithë fëmijëve që të kenë libra të rinj falas. Amendamenti i fundit ka të bëjë me studentët.

Në dy aktet normative të qeverisë nuk janë parashikuar studentët, edhe në mars, edhe në shtator, ndërkohë që kanë bërë një peticion me 6 mijë firma, të cilët kërkojnë një mbështetje me 100 euro në muaj për të përballuar qiranë, që ka shkuar nga 300 në 400 euro, për të përballuar transportin, për të përballuar veshjet dhe të gjitha materialet që ju duhen, pa dyshim librat dhe ushqimet. Ndërkohë, Kosova, me një buxhet më të vogël, i mbështet studentët me 100 euro në muaj, ndërsa ne nuk e parashikojmë fare mbështetjen e studentëve në këtë projektbuxhet. Kështu, t'u japim mundësi studentëve, atyre 6 mijë studentëve që kanë dërguar peticion pranë institucioneve përkatëse, dhe t'i mbështesim financiarisht.

Të nderuar kolegë,

Me gjithë respektin ndaj këtij institucioni, i cili përfaqëson, në fakt, duhet të përfaqësojë, interesin publik përpara çdo interesi tjetër personal apo partiak, ju lutem shihini me pozitivitet këto amendamente, si një shans dhe mundësi për rritjen e buxhetit për arsimin, i cili ka qenë premtimi juaj, në 5% të prodhimit të brendshëm bruto. Faleminderit!